



Si duhet vepruar në rast dyshimi ose konfirmimi të sëmundjes COVID-19 në kompani

Informacion për punonjësit

Ju lutemi merrni seriozisht çdo shenjë që mund t'i referohet sëmundjes COVID-19. Zbulimi i hershëm dhe veprimi i duhur janë të rëndësishme për [të mbrojtur](#) veten, kolegët tuaj dhe personat e tjerë të kontaktit.

Simptomat e mundshme të sëmundjes COVID-19

- Kollë
- Temperaturë
- Vështirësi në frymëmarrje që nuk ka qenë më parë
- Më shumë informacion do të gjeni tek [Instituti Robert Koch](#).

Ja çfarë duhet të bëni nëse dyshoni për COVID-19:

- Ju lutemi qëndroni në shtëpi dhe vini në dijeni punëdhënësen ose punëdhënësin tuaj.
- Kontaktoni përmes telefonit mjeken ose mjekun tuaj të familjes apo departamentin përgjegjës shëndetësor (gjenden tek: <https://tools.rki.de/PLZTool/>). Gjithashtu, mund të kontaktoni me personel mjekësor përmes telefonit në **116117** ose në www.116117.de. Aty do të merri këshilla dhe sqarime për hapat e mëtejshëm.
- **Nëse dyshimi konfirmohet ose nëse dërgoheni në karantinë si një masë paraprake, ju lutemi respektoni rreptësisht masat e sjelljes dhe koordinoni me punëdhënësin tuaj procedurat e mëtejshme.**

Nëse keni patur kontakte me një person të infektuar:

- Para së gjithash, duhet të bëhet një vlerësim mjekësor se sa i lartë është rreziku i infeksionit për ju dhe cilat masa të mëtejshme janë të nevojshme.
- Derisa të ndodhë kjo: kufizoni me patjetër kontaktet tuaja me njerëzit e tjerë. Informoni punëdhënësin ose punëdhënësen tuaj dhe sqarohuni se si do të jetë procedura e mëtejshme.
- Kontaktoni përmes telefonit departamentin përgjegjës shëndetësor (gjenden tek: <https://tools.rki.de/PLZTool/>). Nëse autoritetet ju urdhërojnë të qëndroni në shtëpi si masë paraprake, mund t'ju duhet të flisni me punëdhënësen ose punëdhënësin tuaj për të shmangur disavantazhet financiare. Shënim: E drejta për pagesë të vazhdueshme ekziston vetëm nëse nuk jeni në gjendje të punoni për shkak të sëmundjes në përputhje me § 3 EfZG.
- Informohuni mbi aplikacionin [Corona-App të Charité](#). Aty do të gjeni udhëzime se si të vlerësoni më mirë rreziqet dhe masat e nevojshme të sjelljes.

Kështu ju minimizoni rrezikun e një infeksioni në kompani dhe në kantierët e ndërtimit:

- Respektoni [regullat e distancimit](#).
Kur kjo nuk është e mundur, mbani një [maskë mbrojtëse](#).
- Respektoni me rigorozitet [regullat e higjienës](#): veçanërisht larjen e shpeshtë, tërësore dhe me sapun të duarve, tështitja dhe kollitja vetëm në gropën e krahut.

Më shumë udhëzime do të gjeni tek www.bgbau.de/coronavirus